



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b, dhe të nenit 40, par.3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007, merr

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKTIT IDEOR PËR “RRUGËN E JASHTME UNAZORE” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për Projektin ideor për “Rrugën e jashtme unazore” në Prishtinë. Projekti ideor, nga par.1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike.

Neni 2

Projekti ideor, nga neni 1 i këtij Vendimi, është hartuar duke u bazuar në trajektoren e planifikuar me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 02.07.2004, si dhe në bazë të kontratës DES/01-04, dt. 15.12.2004, të lidhur në mes të Ministrisë së Transportit dhe të Postë – Telekomunikacionit dhe ndërmarrjes “IDROESSE”, si hartues i Projektit ideor.

Neni 3

Projekti ideor, nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t`i nënshtrohet shqyrtimit publik. Shqyrtimi publik i Projektit ideor, sipas këtij Vendimi, zgjatë 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Organizimin e shqyrtimit publik të Projektit ideor, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Projekti ideor, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të jetë bazë për hartimin e projektit zbatues për realizimin e ndërtimit të kësaj rruge unazore, si dhe bazë juridike që toka e planifikuar për realizimin e këtij projekti, të shpallet tokë me interes të përgjithshëm shoqëror.

Neni 5

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Secila drejtori e Komunës së Prishtinës do të kryejë veprime nga përgjegjësia e tij, e caktuar me Statut dhe me rregullsinë ligjore, me qëllim të realizimit të këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 343-204, më 17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri